

Deklaratë e përbashkët e Organizatave Mjedisore

Forumi për Klimën në Shqipëri

Ne, **përfaqësuesit** e 63 Organizatave të Shoqërisë Civile, institucioneve akademike-kërkimore që kontribuojnë në fushën e studimeve për klimën, të mbledhura më 28 Mars 2023, në Tiranë në **“Forumin për Klimën 2023”**, diskutuam mbi emergjencën klimatike dhe cenueshmërinë e vendit tonë, shkallën e përgatitjes për t’u përballuar dhe përshtatur me pasojat e një klime në ndryshim. Shoqëria civile mjedisore në Shqipëri vëren me shqetësim ndikimin në rritje të ndryshimeve klimatike me pasoja të drejtpërdrejta mbi shëndetin dhe sigurinë e komuniteteve të ndryshme, mbi ekonominë dhe mjedisin në përgjithësi.

Me rritjen e temperaturës me +1.09°C në periudhën 2011-2020 krahasuar 1850-1900, referuar raportit vlerësues të IPCC të mars 2023¹, ndryshimet klimatike janë një realitet global. Ky fenomen paraqitet si kërcënim i shtuar ndaj vendeve të vogla si Shqipëria, ku është rritur frekuenca e ngjarjeve ekstreme të motit si përmbytjet, thatësira e tejzgjatur, valët e të nxehtit dhe zjarret në pyje, etj. Rreth 55% e popullsisë së vendit tonë², kryesisht e përqendruar në Ulëtisrën Perëndimore, vlerësohet të jetë e ekspozuar ndaj rreziqeve të lidhura me klimën, një shifër më e lartë se vlerësimi global prej 40-45%. Vetëm gjatë tre muajve të këtij dimri (2022-2023), disa komunitete në Qarkun e Shkodrës janë gjendur tre herë të përmbytura nën vërshimin e ujërave të lumit Drin dhe Buna, sipërfaqet e pyjeve dhe zonave të djegura këtë verë kërcënuan në jo pak raste edhe vetë sezonin turistik, sikundër thatësitat e zgjatura kanë vënë nën presion sektorin energjitik dhe atë bujqësor.

Ndikimi i këtyre fenomeneve ka veprim të drejtpërdrejtë mbi ekonominë me ndikim mbi prodhimin e energjisë nga burimet hidrike, rritjen e konsumit të energjisë, përdorimit të ujit, prodhimin bujqësor e blegtoral, duke cenuar drejtpërdrejtë sigurinë dhe mirëqenien e popullatës. Infrastruktura urbane, përfshirë transportin, sistemet e ujësjellës-kanalizimeve dhe ato të furnizimit me energji gjenden nën presionin e shtuar të ngjarjeve ekstreme të motit, duke cenuar cilësinë e shërbimeve dhe furnizimit, deri në ndërprerjen e tyre, me humbje ekonomike dhe ndikim më të shprehur mbi shtresat e varfra të popullsisë. Sipas raporteve të Komunitetit të Energjisë, kriza energjitike në vitin 2022 ka rritur në 37% përqindjen e popullsisë shqiptare që përballet me varfërinë energjitike³.

Ndryshimet klimatike, sidomos me rritjen e temperaturës kanë sjellë ndryshime në habitatet natyrore dhe biodiversitetin duke rritur presionin mbi habitatet dhe llojet më të kërcënuara, sidomos ato lagunore dhe bregdetare, dhe shtimin e llojeve aliene dhe invazive⁴. Së fundi, por jo nga rëndësia, zonat urbane janë ato të cilat përfshijnë agresivitetin e plotë të këtyre fenomeneve, pasi në tre dekada tranzicioni, betonizimi dhe ndërtimi ka krijuar koracë në mbi 90% të sipërfaqes së tyre. Tjetërsimi i elementeve natyrore në qytete detyron shumë qytetarë të ekspozohen, kundër dëshirës së tyre, në temperatura më të larta se ato që regjistrojnë qendrat meteorologjike, në zona me përqendrim të lartë të ndotësve në ajër, duke rrezikuar shëndetin e tyre.

Vlerësojmë qëndrimin e vendit tonë krahas vendeve të tjera për të adresuar këtë sfidë globale duke marrë angazhime konkrete për uljen e shkarkimeve të gazeve serë me 20.9% deri në vitin 2030 dhe renditur krahas vendeve që synojnë të jenë me shkarkime zero në vitin 2050.

Pavarësisht progresit të bërë gjatë viteve të fundit lidhur me plotësimin e kuadrit ligjor dhe dokumenteve strategjike për klimën, energjinë dhe zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore, si

¹ IPCC (2023): Climate Change 2023, AR6 Synthesis Report (<https://www.ipcc.ch/ar6-syr/>)

² INSTAT (2023) Të dhena kyce për popullsinë <https://www.instat.gov.al/al/statistika>

³ Energy Community (2022): [Policy Guidelines 02/2022-ECS on identifying and addressing energy poverty in the Energy Community Contracting Parties](#), faqe 8

⁴ Government of Albania (2021): Albania revised NDC faqe 50 (<https://unfccc.int/sites/default/files/2022-08/Albania%20Revised%20NDC.pdf>)

dhe zhvillimeve institucionale më të fundit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, **vendi mbetet në shkallë të ulët përgatitjeje për të adresuar emergjencën klimatike dhe arritur objektivat e shprehura për vitin 2030.** Çështjet e klimës përbëjnë një ndër angazhimet më të rëndësishme të Bashkimit Evropian, të cilat nën Axhendën e Gjellbër, po kryejnë një ndryshim transformues të të gjithë ekonomisë evropiane. Në këndvështrimin e detyrimeve që lindin prej procesit të integrimit evropian, shohim me shqetësim progresin e ngadalshëm në adresimin e çështjeve të klimës kundrejt dinamizmit dhe zhvillimeve të vrullshme në vendet anëtare të Komunitetit Evropian. Po kështu, vendi ynë nuk po arrin të përdorë efektivisht mundësitë ende të pashfrytëzuara të burimeve të rinovueshme dhe teknologjitë e pastra, si dhe mundësitë financiare për të zvogëluar impaktin e ndryshimeve klimatike mbi popullatën dhe sektorët e ndryshëm të vendit.

Së fundi por jo për nga rëndësia, nënvizojmë se impakti i ndryshimeve ka përkeqësuar pabarazitë ekzistuese gjinore në Shqipëri duke rritur ndjeshëm barrën për gratë në lehtësimin e këtyre ndikimeve qoftë brenda bërthamës familjare por edhe dimensione më të gjëra socio-ekonomike. Është me rëndësi që politikat dhe programet që zhvillohen në vëndin tonë të lehtësojnë këto ndikime, të cilat aktualisht as njihen dhe as pranohen si të tilla.

Aktivistët e shoqërisë civile mjedisore dhe ekspertët e mjedisit dhe të energjisë konstatojnë se:

1. Kuadri i dokumenteve strategjike për klimën mbetet i papërditësuar dhe paharmonizuar me zhvillimet në vend, rajon, dhe Bashkim Evropian. **Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike e miratuar në vitin 2019 vlerësohet se nuk mbështet prioritetet zhvillimore të vendit në mbrojtje të klimës,** duke listuar ndërhyrje dhe masa të vjetëruara, pa një vlerësim financiar dhe pa një reflektim të detyrimeve institucionale për përmbushjen e tyre.
2. Çështjet e klimës ende mbeten të paintegruara në të gjithë sektorët dhe politikat zhvillimore të vendit. Ndonëse të përfshira në dokumentet strategjike si Plani Kombëtar për Klimën dhe Energjinë, sektorët e tjerë që përballen me pasojat e ndryshimeve klimatike, si **Bujqësia, Transporti, Turizmi, Shëndetësia nuk i kanë të integruara çështjet klimatike,** duke fragmentarizuar ndërhyrjet dhe ndikuar mbi eficiencën e masave kryesisht përshtatëse. Objektivat e vendosura për t'u arritur deri në 2030 apo edhe më tej deri në vitin 2050, nuk reflektohen dhe integrohen në planet sektoriale të veprimit.
3. Adresimi i çështjeve të klimës duhet parë i lidhur me ndërhyrjet transformuese në sektorët kyç të ekonomisë shqiptare, ku planifikimi dhe mbështetja e deritanishme është parë e palidhur me klimën, por me faktorët e tjerë shtytës, si kriza energjitike, rritja e çmimit të produkteve bujqësore, fatkeqësitë natyrore, etj. Pas një periudhe të gjatë në vendqendrim apo me zhvillime të paqëndrueshme, si ato të ndërtimit të HEC-eve të vogla apo të prodhimit të energjisë nga impiante të lëvizshme me djegie të lëndëve fosile, sektori energjistik duket se është i detyruar të hapet drejt energjive të rinovueshme, por ende pak vëmendje kushtohet për eficiencën e energjisë. **Komuniteti i Energjisë ka kritikuar për ngadalësi në marrjen e masave dhe investime për të rritur kontributin e këtyre energjive në totalin e energjisë së prodhuar në vend.** Sektorët e tjerë kontribues në shkarkimet e gazeve serë të vendit tonë, si transporti dhe mbetjet, mbeten ende pa një fokus të qartë të lidhur me klimën. Zhvillimi i tyre ende shihet si zgjidhje e problemeve afatshkurtra, prej së cilave do të ketë përfitim edhe mbrojtja e klimës.
4. **Burimet financiare për të adresuar çështjet e klimës dhe pasojat e ndryshimeve klimatike janë të pamjaftueshme** dhe nuk garantojnë arritjen e objektivave për zvogëlimin e shkarkimeve të gazeve serë apo marrjen e masave përshtatëse deri në vitin 2030. Shqyrtimi i kostove për të adresuar masat për klimën të listuara në Strategjinë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike kundrejt buxhetit të dhënë për vitet 2020-2021, paraqet një nevojë financiare të pambuluar deri në 7 herë. Vërejmë me shqetësim se vlerësimi i efektivitetit të përdorimit të burimeve financiare të buxhetit të shtetit apo fondeve

të huaja është pothuajse i paidentifikueshëm për shkak të pamundësisë së gjurmueshmërisë së fondeve të dedikuara për klimën në sistemin e llogarive të vendit.

5. **Burimet njerëzore në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe agjencive mbeten tepër të kufizuara dhe të pakualifikuara.** Problematika është edhe më e mprehtë në nivelin vendor ku kërkohet avancimi lidhur me plane të ndryshme vendore që do të adresojnë çështjet e klimës. Ky aspekt është referuar në mënyrë të përsëritur për disa vite radhazi edhe në raportet e Komisionit Evropian për vendin tonë.
6. Tranzicioni drejt një ekonomie neutrale për shkarkimet e karbonit, nëpër të cilin duhet të kalojnë komunitetet në vendin tonë do të ketë ndikim social dhe financiar. **Parimi i tranzicionit të drejtë kërkon së paku sigurimin e një procesi transparent.** Si aktivistë të Shoqërisë Civile vlerësojmë se qasja e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe e hapur.
7. **Ministria dhe Agjencitë nën varësinë e saj nuk e zbatojnë kuadrin ligjor në fuqi, sa i takon monitorimit, gjurmimit dhe penalizimit ndaj shkeljeve lidhur me shkarkimet ndotëse në mjedis.**

Ne, përfaqësuesit e Organizatave të Shoqërisë Civile, kërkojmë nga institucionet përgjegjëse politike-bërëse dhe ligjzbatuese që të vlerësohet me seriozitetin më të lartë emergjenca klimatike me të cilën përballlet vendi dhe rajoni. Kjo nevojë për trajtim të shpejtë, të integruar dhe koherent me politikat evropiane bëhet më e shprehur prej pamundësisë së vendit tonë për t'u përballuar me këto pasoja për shkak të rritjes së frekuencës së tyre dhe kufizimeve që kanë institucionet dhe ekonomia e vendit tonë.

Për të adresuar këto problematika, ne kërkojmë:

- (i) **rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Ndryshimeve Klimatike** dhe avancimin më të shpejtë të përgatitjes së dokumenteve të tjera strategjike, si Plani Kombëtar për Përshtatjen, Planet Vendore për Energjinë dhe Klimën, Planet Vendore për Zvogëlimin e Risqeve ndaj Fatkeqësive Natyrore.
- (ii) **rishikimin e vendimit të Qeverisë për Masterplanin e gazit**, duke marrë në konsideratë edhe shkarkimet e CO₂, si dhe masat për balancimin e tyre.
- (iii) plotësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator për monitorimin e shkarkimeve të gazeve serë dhe nxitjen e përdorimit të energjive të rinovueshme dhe teknologjive të pastra në masë të gjerë. Në këtë kuadër, të **rishikohet edhe kontrata e nënshkruar midis KESH dhe kompanive *Excelerate Energy* dhe *Renco*, meqë VNM e thelluar për TEC lundruar referon rritje me 7-13% të shkarkimeve të CO₂ krahasuar me 2016.**
- (iv) **rritjen e përfshirjes së publikut në diskutimin për çështjet klimatike** dhe adresimin e problematikave të lidhura me pasojat klimatike duke vlerësuar me përparësi nevojat e shtresave më të varfra dhe të cenuara të popullsisë që përballen me këto pasoja për të rritur sigurinë e tyre dhe mundësuar ofrimin e shërbimeve;
- (v) **rritjen e transparencës lidhur me fondet dhe investimet e dedikuara apo që ndikojnë mbi klimën**, sidomos në sektorët kyç të ekonomisë, si ato të energjisë, bujqësisë, transportit dhe menaxhimit të mbetjeve.
- (vi) planifikimin dhe programimin e fondeve që adresohen për klimën në programet e BE-së, me fokus përshtatjen dhe parandalimin e pasojave klimatike, sidomos për komunitetet e cenuara dhe ato në nevojë.
- (vii) **mbështetjen për ngritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve profesionale për adresimin e çështjeve të lidhura me klimën në institucionet përgjegjëse**, përfshirë njësitë e qeverisjes vendore dhe shoqërinë civile.

- (viii) **mbështetjen e programeve specifike të edukimit dhe nxitjen e aktivizmit në mbrojtje të klimës** përmes nismave konkrete në nivel komunitar.

Pasojat e ndryshimeve klimatike nuk njohin kufij shtetërorë apo administrativë; ato nuk përzgjedhin se cilët komunitete do të prekin.

Si përfaqësues të shoqërisë civile jemi të ndërgjegjshëm për kontributin që duhet të japim, krahas të gjithë aktorëve të tjerë të shoqërisë shqiptare, ndaj shprehemi të gatshëm për të qenë pjesë aktive e diskutimit dhe veprimit për klimën.

Tiranë, 28 Mars 2023

Forumi Kombëtar i Ndryshimeve Klimatike



Aneks 2 – Agjenda



FORUM KOMBËTAR NDRYSHIMET KLIMATIKE NË SHQIPËRI

THIRRJE PËR VEPRIM TË MENJËHERSHËM PËR INTEGRIM NË POLITIKA SEKTORIALE DHE ZHVILLIM

Qëndrimi i shoqërisë civile në kontekstin e ndërtimit të reziliencës në nivel kombëtar dhe lokal


Objektivat e forumit:

1. Prezantimi i efekteve të verifikuara të ndryshimeve klimatike në Shqipëri.
2. Hartimi i një udhëzuesi të plotë për zbutjen e ndikimeve dhe përshtatjen me impaktet e ndryshimeve klimatike.
3. Integrimi i politikave për klimën dhe reziliencën në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.
4. Vokalizimi i nevojave urgjente për kapacitete të dedikuara njerëzore, teknike dhe financiare në funksion të adresimit të çështjeve që lidhen me klimën në Shqipëri, paralelisht me procesin e integritimit evropian.
5. Fuqizimi i rolit të OSHC-ve dhe kontributi për një Shqipëri më rezistente ndaj ndryshimeve klimatike.

Konteksti kombëtar i iniciativës

Shqipëria po përballë me pasojat e ndryshimeve klimatike, të tilla si frekuenca e shtuar e përmbytjeve, kohëzgjatja e shtuar e periudhës së thatësirave, dhe zjarret e përhapura në pyje. Sikurse referohet edhe nga Paneli Ndërkombëtar për Ndryshimet Klimatike, Shqipëria është vendi më i cënueshëm në Mesdhe për sa i përket efektit të këtyre ndryshimeve në shkallë kombëtare. Ndërsa angazhimi politik e konsideron ndryshimin e klimës një prioritet të vendit, sipas Kontributeve të Përcaktuara Kombëtare të rishikuar (2021), ka kufizime të konsiderueshme kur bëhet fjalë për zbatimin praktik dhe kanalizimin e fondeve dhe burimeve të dedikuara. Përveç kësaj, vendi po bën progres në marrjen e masave sektoriale, si rritja e prodhimit të energjisë së rinovueshme. Gjatë vitit 2023, disa zhvillime të rëndësishme dëshmojnë për këtë progres: projektligji për përdorimin e energjisë së rinovueshme, i cili është për konsultim të hapur publik, dhe miratimi i Projekt-Strategjisë Kombëtare për Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë, së bashku me veprime të tjera pilote, si flota e gjelbër e transportit, zhvillimi i Regjistratit të Shkarkimeve të Gazrave të Gjelbër, etj.

Organizatat e shoqërisë civile dhe publiku i gjerë po ngrenë gjithnjë e më shumë alarmin për pasojat e ndryshimeve klimatike. Gjithnjë e më shumë grupe po angazhohen në iniciativa advokuese për integrimin e klimës në të gjithë sektorët, duke rritur ndërgjegjësimin e publikut të gjerë dhe të institucioneve në nivel qendror e lokal, me synim rritjen e qëndrueshmërisë së komuniteteve përmes veprimeve që nxisin përshtatjen dhe përgatitjen.



Për këtë qëllim, **Green_AL** do të kontribuojë drejtpërdrejt me një deklaratë të përbashkët. Ndërsa për herë të parë komuniteti i OSHC-ve do t'u drejtohet zyrtarisht të gjitha autoriteteve përgjegjëse, mediave dhe publikut në përgjithësi, duke treguar se cënueshmëria dhe qëndrueshmëria kërkojnë ndërhyrje praktike dhe bashkëpunim ndërinstitucional. Shqipëria është një kontribues i vogël në Ndryshimet Klimatike, ndërkohë që një nga më të cënueshmet, prandaj kapacitetet për të zbutur këtë çekuilibër duhet të jenë prioritet në mënyrë që të kanalizohen fondet e brendshme dhe ndërkombëtare nga Sistemi i Shkëmbimit të Shkarkuesve, Taksa e Karbonit, etj. drejt masave dhe projekteve të reziliencës, në nivel lokal dhe kombëtar.

Grupet e synuara, të fluarit dhe folësit

- Përfaqësuesit e OSHC-ve dhe OJF-ve që punojnë në fushën e klimës dhe energjisë.
- Përfaqësuesit e institucioneve të pushtetit qendror përgjegjëse për politikën e klimës.
- Ekspertë të sektorit të klimës dhe të sektorëve të tjerë të ndërlidhur, si dhe akademikë, media, etj.

Moderator: Ola Mitre (Gazetare, Scan TV)

Kohëzgjatja: 09:00-15:30

Vendi: Hotel "Rogner", Salla "Antigonea 2", Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 9, Tiranë 1010

Gjuha: Shqip/Anglisht



Ftesë për pjesëmarrje

Kemi kënaqësinë t'ju ftojme në Forumin Kombëtar mbi Ndryshimet Klimatike në Shqipëri.

Ky Forum organizohet nga REC ALBANIA dhe Forumi i Mendimit të Lirë me mbështetjen e Green-AL.

Datë: 28 Mars 2023

Ora: 9:00 -15:30

Vendi: Hotel Rogner, Tiranë

Ju mirëpresim!

PROGRAMI: FORUMI KOMBËTAR I NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Sesioni	Folësi	Institucioni/Organizata
09.00-09.30	Regjistrimi/Kafe, Çaj	
SESIONI 1	HAPJA / FJALIMI I MIRËSEARDHJES	
09.30-10.00	Mirëseardhja	Mihallaq Qirjo Johan Willert Rodion Gjoka REC Shqipëri, Ambasada e Suedisë (Sida) Co-PLAN
SESIONI 2	KONTEKSTI I PËRGJITHSHËM: CENUESHMËRIA KLIMATIKE NË SHQIPËRI	
10.00-10.15	Ndryshimet klimatike "një realiteti i kushutëshëm" <i>Verifikim faktesh lidhur me klimën në Shqipëri</i>	Petrit Zorba IG JEO
10.15-10.30	Politikat kombëtare: Integrimi i masave të klimës me fokus tek objektivat 2030/2050	Mihallaq Qirjo REC Shqipëri
10.30-11.00	Paneli i Donatorëve: Integrimi i klimës në projektet e asistencës kombëtare	Edvin Pacara Merita Mansaku Meksi Irena Shtraza Elton Qendro Elvira Kabashi Rezart Kapedani Moderator SANE 27 (Sida) Delegacioni i BE-së GIZ UN Women OSBE UNDP
11.00-11.15	Pyetje dhe diskutime	
11.15-11.45	Pushimet (kafë, çaj)	
11.15-11.45	Seancë paralele me mediat	
SESIONI 3	REZILIENCA SEKTORIALE DHE UDHËRRËFYESI PËR PËRSHTATJEN	
11.45-12.00 (10' +5 P&P)	Qëndrueshmëria e sektorit të energjisë së rinovueshme në Shqipëri, eficienta energjike dhe largimi nga djegia e hidrokarbureve	Besim Islami Drejtor i EECG-së (Energy-Environment Consulting Group)
12-12.15 (10' +5 P&P)	Parametrat e bujqësisë dhe blegtorisë në kushtet e një klime që po ndryshon	Albert Kopalli Universiteti Bujqësor i Tiranës
12.15-12.30 (10' +5 P&P)	Ekonomia qarkulluese dhe menaxhimi i mbetjeve	Edlir Vokopola Drejtor i URI-t (Urban Research Institute)
12.30-12.45 (10' +5 P&P)	Planifikimi me përshtatje në Shqipëri	Adelina Greca Drejtoresh e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT)
12.45-13.00 (10' +5 P&P)	Tranzicioni drejt transportit pa shkarkime të dyoksidit të karbonit	Genc Kojdhehi Drejtor i Projekteve Strategjike, Bashkia Tiranë
13.00-14.00	Pushimi i drekës	
SESIONI 4	PERSPEKTIVA EVROPIANE DHE RAJONALE PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE	
14.00-14.15	Hartimi i një Axhende të Gjelbër, të drejtë	Alberto Giacometti Nordregio Green Force Project
14.15-14.30	Objektivat e Ballkanit Perëndimor për vitin 2030: Si t'i arrijmë ato përmes Planeve Kombëtare për Energjinë dhe Klimën (PKEK)	Viktor Berishaj Climate Action Network (CAN) Europe.
SESIONI 5	KONTRIBUTI I OSHC-ve NË KONTEKSTIN E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE	
14.30-15.00	Adresimi nga OSHC-të shqiptare i sfidave kombëtare dhe lokale të shkaktuara nga ndryshimi i kushteve klimatike	Mentor Kikia Endri Haxhiraj Alminda Mema Gentli Kromidha Mevis Struga Kontributi i GREEN_AL për KLIMËN në Shqipëri
15.00-15.15	Deklarata e Projektit: Deklarata e përbashkët e OSHC-ve për integrimin klimatik	Mihallaq Qirjo REC Shqipëri
15.15-15.30	Përfundime	Moderator
15.30	MBYLLJA E AKTIVITETIT	

Aneks 3 – Organizatat nënshkruese të deklaratës

Nr	Emri i organizatës
1.	Qendra Burimore e Mjedisit në Shqipëri (REC Albania)
2.	Forumi i Mendimit të Lirë (FML)
3.	Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit
4.	COSV Albania - Cooperazione per lo Sviluppo
5.	VIS Albania - Volontariato Internazionale per lo Sviluppo
6.	CISP Albania - Sviluppo dei Popoli
7.	Universiteti Polis
8.	Universiteti Bujqësor i Tiranës
9.	Universiteti Shkencave të Natyrës
10.	IGEO Instituti Gjeoshkencave dhe Mjedisit
11.	Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA)
12.	Instituti për Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit (ETMI)
13.	Instituti i Politikave Mjedisore (IEP-IPM)
14.	Agri-En Librazhd
15.	Agro-Eko Dibra
16.	Akademia e Studimeve Politike
17.	Akademia Rinore Pogradec
18.	Shoqata Ornitologjike e Shqipërisë (AOS)
19.	Build Green Group
20.	Edukimi Komunitar për të Drejtat, Kulturë, Integrim (CERCI)
21.	Eco Albania
22.	ECO-Partners for Sustainable Development
23.	Ekologët për Rajonin, Kukës
24.	Qendra Mjedisore për Mbrojtje, Edukim dhe Rehabilitim (EPER Center)
25.	Federata për Përdorimin e Pyjeve dhe Kullotave, Kukës
26.	Instituti për Ndryshim dhe Liderhip në Shqipëri
27.	Klubi Ekologjik Elbasan
28.	LAG Pogradec - Grupi i aktorëve lokalë në mbrojtje të biodiversitetit
29.	Lëvizja Rinore për Demokraci (LRD)
30.	Milieukontakt
31.	Mbrojtja e Mjedisit dhe Zhvillimi i Turizmit (MMZHT)
32.	New Bridge
33.	North Green Association
34.	Organizata e Menaxhimit të Peshkimit (OMP)
35.	Qendra Durrësi Aktiv
36.	Qendra e Informacionit Aarhus, Shkodër
37.	Qendra Sociale në Ndihmë të Njerëzve në Nevojë (QSNN)
38.	Rur.al
39.	Shoqata "Mjedis, Ujëra, Pyje" Përmet
40.	Shoqata "Pylli i Blertë", Pogradec
41.	Shoqata "Ringjallja" Pogradec
42.	Shoqata "Unë, Gruaja"
43.	Shoqata "Agro Puka"
44.	Shoqata "Alpin", Tropojë
45.	Shoqata "Miqesia Ulez", Mat

46.	Shoqata Delfini, Qarku Dibër
47.	Shoqata e Bletarëve, Librazhd
48.	Sindikata Rajonale Korçë
49.	Social Development Investment, Tirane (SDI-AI)
50.	Udhëtimi i Lirë, Durrës
51.	Well Point, Kujdes per te gjithë
52.	Vizion i Gjellbërt
53.	Edukimi Social për mbrojtjen e mjedisit (SEEP)
54.	New Impact
55.	Forumi Shqiptar i Liqenit të Shkodrës (FSLS)
56.	Shoqata Blini
57.	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri – (AWEN)
58.	Shoqata “MENVgroup”
59.	Vjosa Explorer
60.	Nisma e Luleve
61.	GO2
62.	Together for life (TFL)
63.	Përballja e ofertave Politike - Rrjeti POP

Aneks 4 – Protokollet

Drejtuar:

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Nr. 2587 Prot, Datë 20.04.2023

Agjencia Kombëtare të Mjedisit

Nr. 3059 Prot, Datë 20.04.2023

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

Nr. 2053 Prot, Datë 19.04.2023

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura

Nr. 1495 Prot, Datë 20.04.2023

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit

Firmosur, Datë 20.04.2023

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Firmosur, Datë 20.04.2023

Aneks 5 – Versioni i përkthyer i deklaratës

Joint statement by the Environmental Organizations from Forum of Climate Change in Albania

We, **the representatives** of 63 Civil Society Organizations and academic-research institutions involved in climate studies, assembled on March 28, 2023, in Tirana for the "**Climate Forum 2023.**" During the conference, we deliberated on the climate emergency and the susceptibility of our nation, as well as the level of readiness to address and adjust to the effects of a shifting climate. The environmental civil society in Albania expresses apprehension over the escalating influence of climate change, which directly affects the well-being and security of various communities, as well as the overall economy and environment.

According to the IPCC assessment report from March 2023, global climate change has become an undeniable reality, with temperatures rising by approximately +1.09°C during the period of 2011-2020 compared to 1850-1900. This occurrence poses an amplified danger to countries like Albania, particularly due to the increased frequency of extreme weather events such as floods, prolonged droughts, heat waves, and forest fires. Approximately 55% of our country's population, primarily residing in the Western Lowlands, is projected to experience significant exposure to climate-related risks. This figure surpasses the previous global estimate of 40-45%. In the span of just three months this winter, certain communities in Shkodra County experienced three instances of flooding due to the overflowing waters of the Drin and Buna rivers. Additionally, during the summer, areas of forests and burned regions posed a significant threat, jeopardizing even the tourist season in several instances. Prolonged droughts have also placed substantial strain on the energy and agricultural sectors.

The consequences of these phenomena directly affect the economy, particularly in terms of hydroelectric energy production, increased energy consumption, water utilization, and agricultural and livestock output. These factors have a direct impact on the well-being and safety of the population. Urban infrastructure, including transportation, water and sewage systems, and energy supply networks, face mounting pressure from extreme weather events, compromising the quality of services and supplies and potentially leading to disruptions. These disruptions result in economic losses and have a more pronounced effect on impoverished sections of the population. According to the Energy Community reports, the energy crisis in 2022 has elevated the percentage of Albanian citizens facing energy poverty to 37%.

The rise in temperatures, accompanied by climatic changes, has resulted in alterations to natural habitats and biodiversity. This has placed increased pressure on the most vulnerable habitats and species, particularly lagoon and coastal ecosystems, and has led to a rise in the presence of alien and invasive species. Notably, urban areas bear the brunt of these phenomena, as three decades of transition, urbanization, and construction have led to the paving over of more than 90% of their surface area. The loss of natural elements within cities exposes many citizens, often unwillingly, to higher temperatures than those recorded by meteorological centers. These areas also experience high concentrations of pollutants in the air, posing risks to public health.

We evaluate the position of our country next to other countries to address this global challenge by making concrete commitments to reduce greenhouse gas emissions by 20.9% by 2030 and ranked next to countries that aim to have zero emissions in 2050.

Despite recent advancements in establishing a legal framework and strategic documents for climate, energy, and disaster risk reduction, as well as institutional developments in the Ministry of Tourism and Environment, **our country's level of preparedness to address the climate emergency and achieve the stated goals by 2030 remains inadequate.** Climate-related concerns represent a significant commitment for the European Union, which, through the Green

Agenda, is spearheading a transformative shift across the entire European economy. Observing the responsibilities stemming from the European integration process, we are apprehensive about the sluggish progress in addressing climate issues compared to the dynamic and swift advancements witnessed in other member states of the European Community. Additionally, our country has failed to effectively harness the untapped potential of renewable resources, clean technologies, and financial opportunities to mitigate the impact of climate change on our population and various sectors.

Lastly, we emphasize that the effects of these changes have exacerbated existing gender inequalities in Albania, placing a significantly greater burden on women in mitigating these impacts, both within the family unit and in broader socio-economic dimensions. It is crucial that our country's policies and programs address and alleviate these impacts, as they are currently neither recognized nor acknowledged as such.

Environmental civil society activists and environmental and energy experts note that:

1. The strategic climate documents framework remains outdated and lacks alignment with the country's, regional, and European Union's developments. **The National Strategy for Climate Change, approved in 2019, is believed to not adequately support the country's climate protection priorities.** It includes outdated interventions and measures, lacks a financial assessment, and fails to reflect institutional obligations required for their implementation.
2. Climate issues remain unincorporated across sectors and development policies in the country. Although they are included in strategic documents such as the National Climate and Energy Plan, other sectors facing the consequences of climate change, such as **Agriculture, Transportation, Tourism, and Healthcare, have not integrated climate-related matters.** This fragmentation undermines the effectiveness of predominantly adaptive measures. The set objectives to be achieved by 2030 or even further by 2050 are not reflected or integrated into sectoral action plans.
3. Addressing climate issues should be seen as interconnected with transformative interventions in key sectors of the Albanian economy, where current planning and support have been disjointed from climate considerations but rather influenced by other factors such as the energy crisis, rising agricultural prices, natural disasters, etc. After a prolonged period of indecision or unstable developments, such as the construction of small hydropower plants or the reliance on mobile combustion of fossil fuels for energy production, the energy sector appears compelled to shift towards renewable energy sources. However, there is still insufficient attention given to energy efficiency. **The Energy Community has criticized the slow progress in taking action and making investments to increase the contribution of these energy sources to the overall energy production in the country.** Other sectors contributing to our country's greenhouse gas emissions, such as transportation and waste, still lack a clear focus on climate-related issues. Their development is still viewed as a short-term solution, despite the fact that addressing them would also benefit climate protection efforts.
4. **The financial resources allocated to address climate issues and the consequences of climate change are insufficient** and do not guarantee the achievement of objectives for reducing greenhouse gas emissions or implementing appropriate measures by 2030. Assessing the costs to address climate measures listed in the National Strategy for Climate Change compared to the budget provided for the years 2020-2021 reveals an uncovered financial need of up to seven times. We are concerned that the evaluation of the effectiveness of utilizing financial resources from the state budget or foreign funds is almost unidentifiable due to the lack of traceability of funds dedicated to climate within the country's accounting system.

5. **Human resources at all levels of governance and agencies remain severely limited and underqualified.** The issue is even more complex at the local level, where advancements are needed regarding various local plans that will address climate issues. This aspect has been repeatedly mentioned for several consecutive years in the reports of the European Commission concerning our country.
6. The transition towards a carbon-neutral economy, which communities in our country are expected to undergo, will have social and financial implications. **The principle of a just transition requires, at the very least, ensuring a transparent process.** As activists of Civil Society, we appreciate that the approach of the Ministry of Tourism and Environment should be inclusive and transparent.
7. **The Ministry and its subordinate agencies fail to enforce the existing legal framework regarding monitoring, tracking, and penalizing violations related to environmental pollution emissions.**

We, the representatives of Civil Society Organizations, urge the responsible policy-making and law enforcement institutions to take the climate emergency faced by our country and the region seriously. There is an urgent need for swift, integrated, and coherent action aligned with European policies. This need becomes more pronounced due to our country's inability to effectively address the increasing frequency and limitations imposed by institutions and our economy in dealing with these consequences.

To address these issues, we require:

- (i) **The review of the National Strategy for Climate Change** and the expedited advancement of other strategic documents, such as the National Adaptation Plan, Local Plans for Energy and Climate, and Local Plans for Disaster Risk Reduction.
- (ii) **The revision of the government's decision on the Gas Masterplan**, taking into consideration CO2 emissions and measures to balance them.
- (iii) **The completion of the legal and regulatory framework for monitoring greenhouse gas emissions and the promotion of widespread use of renewable energy and clean technologies.** In this context, **the contract signed between KESH and companies Excelerate Energy and Renco should be reviewed, since the EIA for the floating power plants, refers to a 7-13% increase in CO2 emissions compared to 2016.**
- (iv) **Increasing public engagement in discussions on climate issues** and addressing the challenges related to climate impacts, prioritizing the needs of the most vulnerable and marginalized populations who face these consequences, in order to enhance their security and ensure the provision of services.
- (v) **Enhancing transparency regarding funds and investments dedicated to or influencing the climate**, particularly in key sectors of the economy such as energy, agriculture, transportation, and waste management.
- (vi) **Planning and programming funds dedicated to climate in EU programs**, with a focus on climate adaptation and mitigation, especially for marginalized and vulnerable communities in need.
- (vii) **Supporting the establishment and strengthening of professional capacities to address climate-related issues in responsible institutions**, including local government units and civil society.
- (viii) **Supporting specific education programs and promoting activism in climate protection** through concrete community-level initiatives.

The consequences of climate change do not recognize state or administrative borders; they do not choose which communities to affect.

As representatives of civil society, we are aware of the contribution we must make, alongside all other actors in Albanian society. Therefore, we express our readiness to actively participate in discussions and actions for the climate.

Tirana, March 28, 2023

National Climate Change Forum